

Japonik

Agritechnology from Japan

RREGULLATOR
I RITJES SË
BIMËVE

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE "Lexo fletudhëzuesin para përdorimit"

JAPONIK është një rregullator i ritjes së bimeve me ndikim të shumëanshëm si, nxites i rrenjimit dhe ritjes së sistemit rrenjor, vegetacionit, polenizimit, lidhjes dhe pjekjes së frutave, tejkalimit të stresëve të natyrave të ndryshme biotike dhe abiotike, duke ndikuar direkt në ritjen dhe cilesinë e prodhimit. Rrit përqendrimin e nitrofenoleve aromatike në bime duke rezultuar në përshejtimin e qarkullimit citoplazmatik të lengjeve në qelizat bimore dhe për pasojë duke përshejtuar proceset metabolike. Si rezultat i kësaj kemi një mbirje me të shpejtë dhe me uniforme të farërave, një rrenjzim të tyre me të mirë (në volum dhe sasi), rritje masive të bimes, lulezim dhe vitalitet me të mirë të organeve polenizuese, lidhje me të mirë të frutave dhe qëndrueshmëri të tyre, zgjatje të periudhës vegetative, rritje të rendimentit dhe kualitetit të prodhimit. Përdoret gjithashtu edhe si stimulues i sistemit rrenjor në prodhimin e fidanave me copa dhe me fare.

Lenda vepruese: 3 gr/lit Sodium p-Nitrophenolate + 2 gr/lit Sodium o-Nitrophenolate + 1 gr/lit + Sodium 5-Nitroguaiacolate

Formulimi: Leng i tretshëm (SL).

Agritechnology from Japan
A member of OAT Agrio Group

Prodhuar:

Asahi Chemical Manufacturing
Co, Ltd. Japan.

Distributor for Albania:

AGROHELP

AGROHELP SHPK Durres, Tel.: 069 20 55 309/310

1 liter

Masat parambrojtëse:

P102: Mbajeni larg aritjes prej femijeve. P271: Pedoret në ambiente të jashtme ose në zona të ventiluara mirë. P261: Shmangni frymemarrjen mbi sulocion apo avujt e tij. P270: Mos hani, pini apo pini duhan kur përdorni këtë produkt. P273 Shmangni lëshimin në mjedis; P301+P312 NËSE gjithëtitet: Telefononi Qendrën e Helmimeve/ doktor nëse nuk ndiheni mirë.

Informacion shtesë: EUH401 Për të shmangur rrezikun për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, respektoni udhëzimet për përdorim. SP1 Mos ndotni ujrat me produktin ose me Enët e tij. (Mos i pastroji pajisjet e aplikimit afër ujërave sipërfaqësore/Shmangni kontaminimin nëpërmjet kanaleve nga kantieret dhe rrugët).

Gjate punës përdor pajisje mbrojtëse, kominoshe, doreza, maska, syze. Asgjësimi i ambalazheve të behet sipas rregullave në fuqi.

Ndihma e parë dhe keshilla për mjekun: Në rast të ndotjes së syve me materialin shpërkatës i shpallni ato me ujë të bollshëm dhe sapun. **Në rast gjithëtitje aksidentale:** Pas gjithëtitjes, pini 0,5 l ujë të pijshëm të vakët me disa tableta të karbonit aktiv dhe nxisni të vjella. **Në rast thithje:** Personi i aksidentuar nxirret në ajër të pastër, çlirohet nga rrobat në gjoks dhe i siguron ambientet të qetë dhe të ngrohtë. **Në kontakt me lëkurën:** Lani lëkurën e prekur me sapun dhe ujë të ngrohtë. Nëse nuk ndiheni mirë drejtoheni në një qendër spitalore duke marrë me vete etiketën. Nuk ka antidot socif, mjekimi sipas simptomave.

Përdorimi: Domate: Ndikon në rritjen dhe zhvillimin, në celjen dhe mbajtjen e lules dhe cilesinë e frutit. Trajtimi i pare kryhet pas mbjelljes, trajtimi i dyte me cfaqien e lulerise (BBCH5) dhe trajtimi i trete kryhet me celjen e lules së pare (BBG61). Trajtime të tjera mund kryhen për cdo kat. Doza e perdorimit është 0.5 lit/ha, me 500 lit uje/ha. **Spec:** Nxit rritjen zhvillimi e bimesise, lidhjen e frutave dhe zhvillimin e tyre. Përdoret para cfaqies së sythave lulore (BBCH 33-41) me 1 lit/ha ne 500 lit uje/ha. **Pjeper, shalqi, trangull:** Stimulon bimesine dhe rritjen e prodhimit. Kryhen deri tre trajtime/sezon duke filluar nga gjettha e dyte e vertete deri kur fruti i 5-te është gati për vjelje. Doza e perdorimit 0.6 lit/ha, ne 500 lit uje/ha. **Vresht:** Stimulon prodhimin duke nxitur lidhjen e lulerive, volumin e lengut dhe permbajtjen e sheqerit ne te. Trajtimi i pare kryhet para lulezimit me doze 1 lit /ha duke perdorur 1000 lit uje/ha. Trajtimi i dyte pas tre javesh me te njeten doze. **Molle, dardhe:** Stimulon rritjen e prodhimit. Kryhen tre trajtime/sezon, me 0.6 lit/ha, duke filluar kur sythat frutore behen te dukeshme deri kur frutat arrijne ne gjysmen e madhësisë së tyre. **Qersh, kajsi, kumbulla:** Stimulon frutifikimin dhe rritjen e rendimentit. Aplikohet ne tre duar: 3 x 0,6 lit/ha. Fillon nga faza e celjes së luleve deri kur fruti arin 50% të madhësisë së tij. Intervali kohor midis aplikimeve: 7- 14 ditë. Sasia e rekomanduar e ujit: 500 lit/ha. **Agrume:** Stimulon rritjen e prodhimit. Kryhen tre trajtime/sezon, me 0.6 lit/ha, duke filluar kur sythat frutore behen te dukeshme. Trajtimet e tjera kryhen pas lidhjes së frutit deri kur frutat arrijne ne gjysmen e madhësisë së tyre.

Ullinj: Përmireson lulezimin, lidhjen, cilesine dhe sasinë e prodhimit. Kryhen 4 tratime: me cfaqien e sythave, pas 10 ditesh, ne lulezim dhe ne lidhje me doze 1 lit/ha. **Luleshtrydhe dhe manore të tjera:** Stimulon një frutifikim me të mirë dhe ritjen e rendimentit. Aplikohet ne tre duar: 3 x 0,6 lit/ha. Aplikohet nga celja e luleve deri në fazën kur fruti arin 90% të madhësisë së tij. Intervali kohor midis aplikimeve: 7- 14 ditë. Sasia e rekomanduar e ujit: 500 lit/ha.

Grure dhe theker: Stimulon rritjen. Trajtimi i pare ne fazen e vellazerimit dhe trajtimi i dyte me krijimin e nyjes së pare pas nyjes së ngritjes. Intervali midis trajtimeve 10 dite. Doza e perdorimit 0.6 lit/ha. **Panxhar sheqeri:** Stimulon rritjen e rendimentit dhe permbajtjen e sheqerit. Trajtimi i pare kryhet me rritjen e gjetheve te para te verteta, me 0.25 lit/ha me 600 lit uje. Trajtimi i dyte me rritjen e gjetthes se 3-4, me 0.6 lit/ha. **Kolze dimerore dhe pranverore:** Stimulon rritjen e bimes dhe rrit permbajtjen dhe cilesine e vajit. Trajtimi i pare ne fazen e formimit te sythave lulore dhe trajtimi i dyte me fillimin e lulezimit. Doza e perdorimit 0.6 lit/ha me 300-500 lit uje/ha. **Lule dielli:** Rrit prodhimin dhe sasinë e vajit ne koker. Trajtimi i pare me cfaqien e kokes se lules dhe trajtimi i dyte me fillimin e lulezimit. Doza e perdorimit 1 lit/ha me 300-500 lit uje/ha. **Miser:** Stimulon prodhimin. Përdoret ne stadin e 6 gjetheve me 0.6 lit/ha me 300-600 lit uje/ha. **Patate:** Per rritjen e prodhimit dhe cilesine se tubereve. Trajtimi i pare kryhet kur bimët jane ne lartesi 10-15 cm. Doza e perdorimi 0.5 lit/ha me 300-600 lit uje/ha. Trajtimi i dyte me mbylljen e reshëve. Doza e perdorimit 1 lit/ha me 300-600 lit uje/ha. Trajtimi mund te shoqerohet me fungicide per mbrojtjen nga vrugu apo alternaria. **Karote:** Per rritjen e prodhimit dhe cilesite organoleptike te frutrenjoreve. Kryhen tre trajtime me 0.5 lit/ha, me 300-600 lit uje/ha duke filluar nga dy gjethet e verteta deri kur rrenja ka aritur ne 50 % te diametrit perfundimtar. Intervali midis trajtimeve është 10-20 dite, ne vartesi te vegetacionit.

Soje: Stimulon prodhimin dhe rigjenerimin e bimeve nga streset e mundeshme prej temperaturave te uleta pas aplikimit të herbicideve, pas ngricave te pranverës, breshërit etj. Aplikimi i parë: në fazën e 3-5 gjetheve. Doza e rekomanduar e produkti 0,6 lit ne 300-500 lit uje/ha. Aplikimi i dyte në fazën e formimi i kecejve anësore deri në periudhën e para lulezimit. **Për stimulimin e rrenjimit të copave bimore apo kalemave:** Përgatiten copat në mënyrë standarde dhe zhyten ne sulocion 0,33% për 12 orë në temperaturë prej +15 deri në +20°C. Copat shpohen me ujë dhe me pas vendosen ne substraktin e pregatitur per mbirje.

Në pemetari për tejkalimin e demëve nga ngricat e pranverës: Ka gjetur aplikim ne strategjine ant ngrica per tejkalimin e demëve nga ngricat e pranverës. Trajtimi i pare mund te behet 1-3 dite perpara ngricave te parashikuara. Pas disa ditesh kontrollojme gjendjen e demitmit te luleve ose frutave te porsalidhura. Nese gjykojme se ngrica nuk ka shkatuar dem ose ka shkatuar deme te pjeseshme atehere vazhdojme trajtimet rigjeneruese me 3 trajtime tetjere ne intervale 7-10 ditore. Doza e perdorimit është 0.6 lit/ha, me 500 lit uje/ha.

Në të gjitha kulturat për tejkalimin e stresëve biotike dhe abiotike: Ka gjetur perdorim ne rigjenerimin e demëve qe munde te vijne nga streset abiotike dhe biotike, sic mund te jene rastet e atakimit nga semundjet duke nxitur mekanizmat vetmbrojtjes tek bimët, streset nga temperaturat ekstreme, thatesia e zgjatur, plaget e shkatruara nga breshëri, fitotoksitetet e ndryshme nga herbicidet apo faktore te tjere.

Fitoksiditeti: Nuk është fitotoksik.

Verejtje për përdorimin: Përzihet me të gjitha llojet e PMB-ve. Shtimi i agjentëve lages si SILWET GOLD rrit efikasitetin e produktit. Efektet pozitive qe sigurohen nga perdorimi i JAPONIK jane me te garantuar nese bimët kultivohen ne kushtet e një ushqimi dhe ujitje te balancuar dhe optimale.

Ndikimi në ekosistem: Nuk konsiderohet helmues për bletën dhe orgnizmat ujore. Megjithatë evitoni perdorimin e ketij produkti ne zonat e mbrojtura per burimet e ujrave te pijshme. Evitoni shkakimin e mbetjeve te produktit dhe eneve te tyre ne ujrart mbitokësore.

Karenca: 4 dite.

Magazinimi: Produkti ruhet ne ambalazhe origjinale dhe te pa hapura me pare, ne ambiente te ventiluara mire, i pa ekspozuar nga rrezet e diellit.

Nr. dhe dt. e regjistrimit: Nr. 446, datë 1.7.2024

Dt. Mf./Lot: Printuar në shishe